



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

P.nr. 991/2021

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të pa B .Z me vendbanim në fsh Zh , Komuna e Gji , për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1932/2021 të datës 01.12.2021, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 10.02.2022, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pa B . Z i lindur më, në Gj , me numër 1, i biri i S . Z dhe nënës R e gjinisë A , me vendbanim në fsh Zh rr. "A Z " p n. i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar baba fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar ndërsa nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 15.11.2021, rreth orës 13:45 minuta, në territorin e fsh. G. i V , komuna e Gj , në pyllin e pronës shtetërore, tek vendi i quajtur "G", i pa B . Z , me qëllim të vjedhjes, me sharrë motorike, ka prerë 27 copë trungje të njoma, të llojit "Shkozë", me diametër në cung 15-20 cm, me diametër mesatar 12 cm, gjatësi 8 m, si dhe me vëllim të përgjithshëm prej 4.69 m<sup>3</sup>, në këtë mënyrë të dëmtuarës APK-së, zyra në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumën prej rreth 703 euro.

-me çka ka kryer vepër penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi të KPRK-s.

Prandaj gjykata në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, dhe 72 si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin:

**E G J Y K O N**

**I.** Të pa B . Z , për vepër penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin do ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

**II.** Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

**III.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

IV. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 01.12.2021 ka ngritur aktakuzën e lartë cekur, ndaj të ak B . Z me vendbanim në fsh Zh . Komuna e Gj , për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s. Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 10.02.2022 prezent ishin prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq dhe i pa B . Z , i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, ka deklaruar se e pranon fajsinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës.

### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pa B . Z për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pa B . Z ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të ak B . Z për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të ak B . Z si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata merr për bazë dëmin material, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit.

### 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të ak B . Z duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi për kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 991/2021-Më 10.02.2022**

**Sek. Juridike**

Fatmire Sermaxhaj d.v

**Gjyqtar,**

Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi pala e dëmtuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurores së shtetit dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli,

NË EMËR TË POPULLIT  
A K T G J Y K I M

I pandehuri Besim Zenuni i lindur më 20.03.1971, në Gjilan, me numër 1000319755, i biri i Sabri Zenuni dhe nënës Rexhije e gjinisë Ajvazi, me vendbanim në fshatin Zhegër rr. “Avni Zenuni” p n. i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar baba i 4 (katër) fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar ndërsa nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 15.11.2021, rreth orës 13:45 minuta, në territorin e fshatit Goden i Vogël, komuna e Gjilanit, në pyllin e pronës shtetërore, tek vendi i quajtur “Gashticë”, i pandehuri Besim Zenuni, me qëllim të vjedhjes, me sharrë motorike, ka prerë 27 copë trungje të njoma, të llojit “Shkozë”, me diametër në cung 15-20 cm, me diametër mesatar 12 cm, gjatësi 8 m, si dhe me vëllim të përgjithshëm prej 4.69 m<sup>3</sup>, në këtë mënyrë të dëmtuarës APK-së, zyra në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumën prej rreth 703 euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi të KPRK-s.  
Prandaj gjykata në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, dhe 72 si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin:

**E G J Y K O N**

**I.** Të pandehurit **Besim Zenuni**, për veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin do ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

**II.** Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

**III.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**IV.** Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 10:40 min.

V ë r t e t o j n ë

Sek. juridike,

G j y k a t ë s i